

## 3.7 HIDROIZOLUES ME REZISTENCË TË LATË PËR INDUSTRIJË E RËNDË, HIDROCENTRALE ETJ

### EPOXY BITUM Z 877



| Njësia matëse           | pcs/pallet                   | Konsumi               | Ngjyra/specifikime të tjera |
|-------------------------|------------------------------|-----------------------|-----------------------------|
| 5 kg/kovë<br>15 kg/kovë | 60 cp/paletë<br>36 cp/paletë | 1-2 kg/m <sup>2</sup> | Gri                         |



#### EPOXY BITUM Z 877

Hidroizolues me bazë epoksi bitum me veti të mira ngjitëse dhe rezistente ndaj kimikateve.

#### KARAKTERISTIKAT

EPOXY BITUM Z 877 është një material lyerës hidroizolues me bazë epoksi bitum.

- Ofron një hidroizolim dhe elasticitet të lartë.
- Karakterizohet nga aftësi shumë të mira ngjitëse në të gjitha sipërfaqet me bazë çimento si edhe të atyre të përbëra prej tulle druri ose metali dhe mbi çdo lloj tjetër material hidroizolues. Mundësi përdorimi dhe në shtresa ta paniveluara.
- Siguron elasticitet të lartë duke evituar formimin e çarjeve dhe plasaritjeve që mund të krijohen me kalimin e kohës.
- Rezistencë ndaj kimikateve.

#### FUSHA E PËRDORIMIT

EPOXY BITUM Z 877 përdoret si hidroizolues nëpër tarraca, ballkone, mure, si edhe në vënde me lageshti. Aplikohet lehtësisht duke krijuar një membranë hidroizoluese me elasticitet të lartë dhe rezistencë mekanike pa krijuar çarje ose tkurrje. Gjithashtu, është lehtësisht i aplikueshëm në zonat e vështira si kënde, bashkime të materialeve të ndryshme që formojnë fuga etj. EPOXY BITUM rekomandohet të përdoret për hidroizolim të bodrumeve nëntokësor si edhe në ato ambiente ku kërkohet rezistencë e lartë ndaj kimikateve.

#### MËNYRA E PËRDORIMIT

##### Përgatitja e sipërfaqes

Sipërfaqet ku do të aplikohet materiali duhet të jenë të pastra nga pluhurat, bojërat, etj. Në mënyrë që të arrihet një hidroizolim sa më i mirë rekomandohet që sipërfaqja që do të hidroizolohet me EPOXY BITUM Z 877 të trajtohet paraprakisht me astarin RESIN RE 1800.

##### APLIKIMI

EPOXY BITUM Z 877 aplikohet në dy duar me furçë ose me rrul, mbasi të jetë tharë plotësisht astari i aplikuar paraprakisht mbi sipërfaqen që do të hidroizolohet. Konsumi është afërsisht 1 - 2 Kg/m<sup>2</sup> në varësi të sipërfaqes që do të hidroizolohet. Dora e dytë duhet të aplikohet vetëm pasi shtresa e parë të jetë tharë plotësisht, duhet ti kushtohet kujdes që aplikimi i shtresës së dytë të bëhet në formë kryq mbi shtresën e parë.

##### KONSUMI

Konsumi është afërsisht 1 - 2 Kg/m<sup>2</sup>

##### JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

Ruhet në mjedise të mbrojtura nga ngricat deri në 18 muaj nga data e prodhimit.

##### PAKETIMI

Ne kova 5 Kg dhe 15 Kg.

